



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2025 – Numri: 181

Tiranë – E mërkurë, 8 tetor 2025

PËRMBAJTJA

		Faqe
Udhëzim i ministrit të Punëve të Brendshme nr. 159, datë 2.10.2025	Për procedurat e hartimit të listave të zgjedhësve për zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar bashkie, për disa njësi të qeverisjes vendore.....	22175
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 956, datë 2.10.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Gjermanisë	22177
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 964, datë 3.10.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajes afrikane të derrave, të shfaqur në shtetin e Bosnjë-Hercegovinës.....	22178
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 965, datë 3.10.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Spanjës.....	22181



UDHËZIM

Nr. 159, datë 2.10.2025

PËR PROCEDURAT E HARTIMIT TË LISTAVE TË ZGJEDHËSVE PËR ZGJEDHJET E PJESSHME VENDORE PËR KRYETAR BASHKIE, PËR DISA NJËSI TË QEVERISJES VENDORE

Në zbatim të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të neneve 45, 46, 47, 48, 50, 51, 56, 57, 59 dhe 62, të ligjit nr. 10 019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të dekretit nr. 350, datë 1.10.2025, të Presidentit të Republikës, “Për caktimin e datës së zgjedhjeve të pjesshme vendore për kryetar bashkie, për disa njësi të qeverisjes vendore”,

UDHËZOJ:

1. Hartimin e ekstraktit elektronik për zgjedhjet e pjesshme vendore nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile (RKGjC) i vitit 2010, brenda datës 3.10.2025. Në përbërje të listës së zgjedhësve janë të gjithë shtetasit me të drejtë vote, të lindur deri më datë 9.11.2007, të cilët në datën e zhvillimit të zgjedhjeve për kryetar të bashkive Tiranë, Vlorë, Berat, Tepelenë, Mat dhe Cërrik, më datë 9.11.2025, mbushin 18 vjeç.

2. Miratimin dhe shpalljen e listës së zgjedhësve për zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar të bashkive Tiranë, Vlorë, Berat, Tepelenë, Mat dhe Cërrik, në përputhje me nenin 48 të Kodit Zgjedhor brenda datës 6.10.2025, nga kryetarët e komanduar në detyrë në bashkitë Tiranë, Vlorë, Berat, Tepelenë, Mat dhe Cërrik.

3. Gjenerimin e listës së zgjedhësve, në përputhje me procedurën e parashikuar në udhëzimin nr. 225, datë 11.5.2016, të ministrit të Punëve të Brendshme, “Për procedurat e pezullimit nga lista e zgjedhësve për shtetasit që vuajnë dënimin, parashikuar nga ligji nr. 138/2015, ‘Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike’”.

4. Caktimin e zgjedhësve në listën e qendrës së votimit përkatëse, sipas kodit të vendbanimit. Renditjen e zgjedhësve brenda qendrës së votimit sipas rendit alfabetik të mbiemrit.

5. Grupimin e listës së zgjedhësve për zgjedhjet e pjesshme vendore sipas zonave të qendrave të votimit, kufijtë e të cilave janë ato të zgjedhjeve të fundit. Kryetarët e bashkive Tiranë, Vlorë, Berat, Tepelenë, Mat dhe Cërrik, të komanduar në detyrë, të cilët kanë marrë njoftimin nga nëpunësi i zyrës së gjendjes civile në bashkitë Tiranë, Vlorë, Berat, Tepelenë, Mat dhe Cërrik/njësitë administrative nën juridiksionin e tyre, se ka qendra votimi me më pak se 300 (treqind) zgjedhës, apo qendra votimi me më shumë se 1 000 (një mijë) zgjedhës, brenda 48 orëve vendos për bashkimin dhe/ose ndarjen e qendrave të votimit, sipas kërkesave të kriterit numerik dhe cakton adresën e qendrës së votimit.

6. Limiti i poshtëm për qendrën e votimit i referohet një numri prej 15 (pesëmbëdhjetë) zgjedhësish, në rastin e institucioneve të posaçme (burgjeve, vendeve të paraburgimit, si dhe spitaleve ose institucioneve të tjera shëndetësore, që pranojnë pacientë për më shumë se 3 ditë), të cilat përbëjnë zonë të veçantë qendre votimi.

7. Kryetari i bashkisë Tiranë, Vlorë, Berat, Tepelenë, Mat dhe Cërrik, i komanduar në detyrë, vendos për rindarjen e qendrave të votimit me fraksion që kalojnë limitin numerik të përcaktuar në Kodin Zgjedhor, duke u nisur nga numri i përgjithshëm i zgjedhësve të qendrës së votimit bazë. Numri i përgjithshëm i një qendre votimi, me gjithë fraksionet e saj ndahet në pjesë të barabarta, me jo më shumë se 1000 (një mijë) zgjedhës secila.

8. Kryetari i Bashkisë Tiranë, Vlorë, Berat, Tepelenë, Mat dhe Cërrik, i komanduar në detyrë, vendos për bashkimin e qendrave të votimit me më pak se 300 (treqind) zgjedhës, me një qendër më të afërt dhe me mundësi komunikimi rrugor. Numri i përgjithshëm i zgjedhësve në qendrat e bashkuara të votimit duhet të jetë mbi 300 (treqind) zgjedhës.

Kryetari i komanduar në detyrë në bashkinë Tiranë, Vlorë, Berat, Tepelenë, Mat dhe Cërrik, vendos për ndarjen me fraksion të qendrës së votimit të krijuar, në rastet kur numri i përgjithshëm i zgjedhësve për qendrat që bashkohen rezulton të jetë më shumë se 1 000 (një mijë), sipas pikës 7 të këtij udhëzimi. Në rastet kur dy ose më shumë qendra votimi kanë më pak se 300 (treqind) zgjedhës, qendra/qendrat me numër më të vogël i bashkohen atyre me numër më të madh zgjedhësish.

9. Kryetari i komanduar në detyrë në bashkitë Tiranë, Vlorë, Berat, Tepelenë, Mat dhe Cërrik, u dërgon menjëherë për zbatim zyrës së gjendjes civile



në bashkitë Tiranë, Vlorë, Berat, Tepelenë, Mat dhe Cërrik/zyrave të gjendjes civile nën juridiksionin e tyre, vendimet për ndarjen ose bashkimin e qendrave të votimit, si dhe vendimet për ndryshimin e adresave të qendrave të votimit nëse ka. Këto vendime, gjithashtu, dërgohen në Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile në Ministrinë e Punëve të Brendshme, si dhe për dijeni prefektit të qarkut Tiranë, Vlorë, Berat, Gjirokastrë, Dibër dhe Elbasan.

10. Përgjegjësi i zyrës së gjendjes civile në bashkitë Tiranë, Vlorë, Berat, Tepelenë, Mat dhe Cërrik /njësitë administrative nën juridiksionin e tyre, kryen veprimet përkatëse në Regjistrin Kombëtar, brenda 24 orëve nga marrja e vendimit të kryetarit të komanduar në bashkinë Tiranë, Vlorë, Berat, Tepelenë, Mat dhe Cërrik, për ndarjen e qendrave të votimit referuar kriterëve të parashikuar ligjorë.

11. Nëpunësit e zyrave të gjendjes civile në bashkitë Tiranë, Vlorë, Berat, Tepelenë, Mat dhe Cërrik/ njësitë administrative nën juridiksionin e tyre, përditësojnë informacionin për ndarjen e qendrave të votimit në Regjistrin Kombëtar deri në orën 24:00 të së njëjtës dite. Në rastet kur përditësimet për ndarjen e qendrave të votimit nuk kryhen nga nëpunësit e zyrave të gjendjes civile, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile ekzekuton automatikisht vendimet e kryetarëve të komanduar në detyrë për ndarjen e qendrës së votimit sipas kriterit numerik dhe mbiemrit të zgjedhësit. Qendrat e votimit me fraksion marrin automatikisht vendndodhjen e qendrës bazë.

Nëpunësit e zyrave të gjendjes civile në bashkitë Tiranë, Vlorë, Berat, Tepelenë, Mat dhe Cërrik/ njësitë administrative nën juridiksionin e tyre, kryejnë veprimet përkatëse në rubrikën e dedikuar në Regjistrin Kombëtar, për përditësimin e përshkrimit të vendndodhjes së qendrës së votimit me fraksion, në rastet kur kryetari i komanduar në bashkinë Tiranë, Vlorë, Berat, Tepelenë, Mat dhe Cërrik vendos që vendndodhja e qendrës së votimit me fraksion të jetë e ndryshme nga ajo e qendrës bazë.

12. Procedurat e parashikuara në pikat 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10 dhe 11 të këtij udhëzimi, kryhen për listën e zgjedhësve për zgjedhjet e pjesshme vendore, brenda datës 6.10.2025, që do të publikohet për zgjedhjet për kryetar të bashkive Tiranë, Vlorë, Berat, Tepelenë, Mat dhe Cërrik.

13. Në rastet kur kryetarët e komanduar në detyrë në bashkitë Tiranë, Vlorë, Berat, Tepelenë, Mat dhe Cërrik, nuk përmbushin detyrimet e parashikuara sipas pikave 5, 6, 7 dhe 8 të këtij udhëzimi, deri në publikimin e listës së zgjedhësve, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, kryen menjëherë procesin e ndarjes dhe/ose bashkimin e qendrave të votimit sipas kriterëve të përcaktuara në Kodin Zgjedhor, të cilat reflektohen në listën e zgjedhësve, datë 6.10.2025, për kryetar të bashkive Tiranë, Vlorë, Berat, Tepelenë, Mat dhe Cërrik.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile realizon bashkimin/ndarjen e qendrave të votimit në përmbushje të këtij procesi, bazuar në kriterin numerik dhe mbiemrin e zgjedhësit. Qendrat e votimit me fraksion marrin automatikisht adresën e qendrës bazë.

Nëpunësit e zyrave të gjendjes civile në bashkitë Tiranë, Vlorë, Berat, Tepelenë, Mat dhe Cërrik/ njësitë administrative nën juridiksionin e tyre, kryejnë veprimet përkatëse në Regjistrin Kombëtar për përditësimin e vendndodhjes së qendrës së votimit, në rastet kur kryetari i komanduar në detyrë në bashkitë Tiranë, Vlorë, Berat, Tepelenë, Mat dhe Cërrik ka vendosur që vendndodhja e qendrës së votimit me fraksion, të jetë e ndryshme nga ajo e qendrës bazë.

14. Nëpunësit e zyrave të gjendjes civile në bashkitë Tiranë, Vlorë, Berat, Tepelenë, Mat dhe Cërrik/ njësitë administrative nën juridiksionin e tyre, më datë 6.10.2025, printojnë listën e zgjedhësve nga Regjistri Kombëtar. Nëpunësit nënshkruajnë, vulosin listën e zgjedhësve për çdo qendër votimi, përfshirë këtu edhe institucionet e posaçme. Nëpunësit i dorëzojnë kryetarëve të komanduar në detyrë në bashkitë Tiranë, Vlorë, Berat, Tepelenë, Mat dhe Cërrik, listën e zgjedhësve të pjesshme vendore të nënshkruar dhe të vulosur.

15. Kryetari i komanduar në detyrë dërgon në KZAZ të 3 (tre) formatet e parashikuara në shkronjat “a”, “b” dhe “c”, të pikës 2, të nenit 48 të Kodit Zgjedhor, jo më vonë se 35 ditë nga data e zhvillimit të zgjedhjeve për kryetar të bashkive Tiranë, Vlorë, Berat, Tepelenë, Mat dhe Cërrik.

16. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile dërgon në KZAZ të 3 (tre) formatet e listës së zgjedhësve të pjesshme vendore, në rast se nga kryetarët e komanduar në detyrë për bashkitë Tiranë, Vlorë, Berat, Tepelenë, Mat dhe Cërrik, nuk



përmbushen kompetencat sipas pikës 15 të këtij udhëzimi.

17. Zyrtat e gjendjes civile në bashkitë Tiranë, Vlorë, Berat, Tepelenë, Mat dhe Cërrik/njësitë administrative nën juridiksionin e tyre, ku do të zhvillohen zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar bashkie, zbatojnë dhe vendimet gjyqësore, sipas nenit 57, të ligjit nr. 10 019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

18. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile publikon listën e zgjedhësve në formë elektronike për zgjedhjet për kryetar të bashkive Tiranë, Vlorë, Berat, Tepelenë, Mat dhe Cërrik, në faqen zyrtare të internetit të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

19. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile i dërgon për ruajtje Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave një kopje të printuar të listës së zgjedhësve, jo më vonë se 10 ditë pas shpalljes së listës së zgjedhësve të pjesshme vendore për kryetar të bashkive Tiranë, Vlorë, Berat, Tepelenë, Mat dhe Cërrik.

20. Ngarkohen me zbatimin e këtij udhëzimi kryetari i komanduar në detyrë në bashkitë Tiranë, Vlorë, Berat, Tepelenë, Mat dhe Cërrik, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, zyrtat e gjendjes civile në bashkitë Tiranë, Vlorë, Berat, Tepelenë, Mat dhe Cërrik dhe në njësitë administrative nën juridiksionin e tyre, si dhe institucionet e tjera shtetërore të parashikuara nga Kodi Zgjedhor.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I PUNËVE TË BRENDSHME
Albana Koçi

URDHËR
Nr. 956, datë 2.10.2025

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE
ME PATOGJENITET TË LARTË TË
SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË
SHTETIN E GJERMANISË**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

- a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;
- b) zogjve 24-orësh;
- c) shpendëve dekorativë;
- ç) materialit biologjik të shpendëve;
- d) vezëve të shpendëve;
- dh) mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht;
- e) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Gjermanisë, janë sipas tabelës së mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3
Schleswig-Holstein	Steinburg	Schenefeld*
Mecklenburg-Vorpommern	Rostock	Tessin*
Nordrhein-Westfalen	Paderborn	Delbrück*

Shënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

3. Certifikata veterinarë të garantojë origjinën e ngarkesës së ardhur.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve informojnë të gjitha subjektet importuese të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

5. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

6. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht që vijnë nga vendet e sipërcituara në pikën 2.



7. Urdhri nr. 886, datë 16.9.2025, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetën e Gjermanisë”, shfuqizohet.

8. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Drejtoria e Politikave Veterinare, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Andis Salla

URDHËR
Nr. 964, datë 3.10.2025

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË MURTAJËS AFRIKANE
TË DERRAVE, TË SHFAQUR NË
SHTETIN E BOSNJË-HERCEGOVINËS**

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës, pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, mishit të freskët dhe produkteve të tij, materialit biologjik dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra, duke përfshirë mishin në një kontejner të vulosur (mbyllur) hermetikisht me një vlerë të F_0 prej 3 ose më lart, xhelatinën, ushqimin e thatë të kafshëve shtëpiake, dhe vakteve proteinike sipas njoftimeve të marra nga faqja zyrtare e Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe ADIS-it, përkatësisht nga ndarjet administrative të përcaktuara në tabelën e mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3
Republika Srpska	Bijeljina	Bijeljina*
Republika Srpska	Bijeljina	Lopare*
Federacija Bosna i Hercegovina	Posavina	Orašje*
Federacija Bosna i Hercegovina	Herzegovina-Neretva	Prozor-Rama*
Republika Srpska	Bijeljina	Ugljevik*
Republika Srpska	Doboj	Šamac*
Republika Srpska	Doboj	Donji Žabar*
Republika Srpska	Doboj	Modriča*
Republika Srpska	Doboj	Pelagićevo*
Republika Srpska	Doboj	Doboj*
Republika Srpska	Doboj	Petrovo*
Republika Srpska	Istočno Sarajevo	Pale*
Republika Srpska	Istočno Sarajevo	Sokolac*
Republika Srpska	Istočno Sarajevo	Istočni Stari Grad*
Republika Srpska	Trebinje	Nevesinje*
Republika Srpska	Trebinje	Gacko*
Republika Srpska	Foča	Kalinovik*
Republika Srpska	Foča	Foča*
Republika Srpska	Vlasenica	Bratunac*
Republika Srpska	Vlasenica	Milići*
Republika Srpska	Vlasenica	Osmaci*
Republika Srpska	Vlasenica	Šekovići*
Republika Srpska	Vlasenica	Vlasenica*
Republika Srpska	Vlasenica	Zvornik*
Brčko	Brčko	Brčko*
Republika Srpska	Banja Luka	Bosanska Gradiška*
Federacija Bosna i Hercegovina	Posavina	Orašje*
Federacija Bosna i Hercegovina	Central Bosnia	Busovača*
Federacija Bosna i Hercegovina	Central Bosnia	Kreševo*
Federacija Bosna i Hercegovina	Central Bosnia	Vitez*
Federacija Bosna i Hercegovina	Sarajevo	Vogošća*
Federacija Bosna i Hercegovina	Sarajevo	Hadžići*
Federacija Bosna i Hercegovina	Sarajevo	Ilijaš*
Federacija Bosna i Hercegovina Sarajevo	Sarajevo	Tmovo*
Federacija Bosna i Hercegovina Sarajevo	Sarajevo	Vogošća*
Federacija Bosna i Hercegovina Sarajevo	Sarajevo	Stari Grad Sarajevo*
Federacija Bosna i Hercegovina	Tuzla	Teočak*
Federacija Bosna i Hercegovina	Tuzla	Sapna*
Federacija Bosna i Hercegovina	West Herzegovina	Široki Brijeg*
Federacija Bosna i Hercegovina	West Herzegovina	Posušje*



Federacija Bosna i Hercegovina	Zenica-Doboj	Žepče*
Federacija Bosna i Hercegovina	Bosnian Podrinje	Foča-Ustikolina*

Shënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

2. Lejimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, mishit të freskët dhe produkteve të tij, materialit biologjik dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra, nga ndarjet administrative të shtetit të Bosnjë-Hercegovinës, të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, të paineduara nga sëmundja, nëse plotësohen kushtet e mëposhtme nga pika 2.1 deri në pikën 2.8:

2.1 Për kafshët e gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që kafshët:**

a) nuk kanë shfaqur shenja klinike të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave ditën e dërgesës;

b) janë mbajtur që nga lindja ose për tre muajt e fundit në një kompartment (zonë) pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave; ose

c) janë mbajtur në një stacion karantine, të izoluar për 30 ditë përpara dërgesës dhe i janë nënshtruar një testi virologjik dhe një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas hyrjes në stacionin e karantinës, me rezultate negative.

2.2 Për materialin biologjik të kafshëve të llojit derra të butë ose të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që kafshët donatore të materialit biologjik:**

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muaj para grumbullimit në një stacion, në të cilin janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe vërteton se asnjë rast i sëmundjes së murtajës afrikane të derrave, nuk ka ndodhur në tre vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstion, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenja klinike të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së materialit biologjik;

c) sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7 të

Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

ç) sperma e përdorur për fekundimin e ovociteve është në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 15.1.10 ose nenin 15.1.11 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve, sipas rastit.

2.3 Për embrionet e derivuara *in vivo* të derrave të butë, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që kafshët donatore të embrioneve:**

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muaj para grumbullimit të embrioneve në një stacion, në të cilën janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe vërteton se asnjë rast i sëmundjes së murtajës afrikane të derrave, nuk ka ndodhur në tre vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstion, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenjë klinike të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së embrioneve;

c) i janë nënshtruar një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas grumbullimit, me rezultate negative;

ç) embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me dispozitat përkatëse të kapitujve 4.8 dhe 4.10 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve.

2.4 Për mishin e freskët të kafshëve të llojit derra të butë ose të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**

a) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshët e llojit derra që kanë origjinën nga tufat në të cilat janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe vërteton se asnjë rast i sëmundjes së murtajës afrikane të derrave nuk ka ndodhur në tre vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstion, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;



b) janë testuar mostra nga një numër statistikisht përfaqësues i kafshëve për sëmundjen e murtajës afrikane të derrave, me rezultate negative;

c) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshë të cilat janë therur në një thertore të miratuar dhe i janë nënshtruar kontrollit me rezultate të favorshme të inspektimit para dhe pas vdekjes në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

ç) janë marrë masat e nevojshme pas therjes për të shmangur kontaktin e mishit të freskët me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.5 Për mishin e freskët të kafshëve të egra të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet që:**

a) janë vrarë në një vend ose zonë të lirë nga sëmundja e murtajës afrikane të derrave në përputhje me pikën 1 ose pikën 2, të nenit 15.1.4 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

b) i janë nënshtruar me rezultate të favorshme një inspektimi pas ngordhjes në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve në një objekt ekzaminimi të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti.

2.6 Për produktet e mishit të kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet që:**

a) janë përgatitur nga mishi i freskët plotëson kushtet përkatëse në nenet 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

b) mishi është përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti dhe ka plotësuar kushtet përkatëse të neneve 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve; ose

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, në mënyrë që të sigurohet shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave në përputhje me nenin 15.1.23 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë marrë masat e nevojshme pas

përpunimit të mishit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.7 Për qimet (e pjesës së shpinës) e kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet që:**

a) e kanë origjinën nga derrat e egër të mbajtur ose të butë të kapur në një vend, zonë ose ndarje pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

b) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti ku është siguruar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave në përputhje me një nga proceset e listuara në nenin 15.1.26 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin me produktin me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.8 Për lëkurët e kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet që:**

a) kanë ardhur nga derra të një vendi ose zonë të lirë nga sëmundja e murtajës afrikane të derrave, në përputhje me pikën 1 ose pikën 2, të nenit 15.1.4, të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

b) origjinojnë nga derra të egër të mbajtur ose të butë të kapur në një vend, zonë ose kompartament pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, ku është siguruar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave në përputhje me një nga procedurat e përmendura në nenin 15.1.25 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë marrë masat paraprake të nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

3. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes



së Bimëve të informojnë të gjitha subjektet importuese të kafshëve të llojit derra, produkteve dhe nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

4. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

5. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të kafshëve të llojit derra, produkteve dhe nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre.

6. Urdhri nr. 741, datë 30.7.2025, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajës afrikane të derrave të shfaqur në shtetin e Bosnjë-Hercegovinës”, shfuqizohet.

7. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Andis Salla

URDHËR
Nr. 965, datë 3.10.2025

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE
ME PATOGJENITET TË LARTË TË
SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË
SHTETIN E SPANJËS**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

- a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;
- b) zogjve 24-orësh;
- c) shpendëve dekorativë;
- ç) materialit biologjik të shpendëve;
- d) vezëve të shpendëve;
- dh) mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht;
- e) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Spanjës, janë sipas tabelës së mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3
Castilla - La Mancha	Toledo	Oropesa*
Extremadura	Badajoz	Azuaga*
Andalucía	Huelva	Valverde del Camino (Andevalo Oriental)*
Castilla - La Mancha	Guadalajara	Guadalajara*
Castilla y León	Valladolid	Olmedo*
Comunidad de Madrid	Madrid	Aranjuez*

Shënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

3. Certifikata veterinare të garantojë origjinën e ngarkesës së ardhur.

4. Urdhri nr. 915, datë 22.9.2025, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Spanjës”, shfuqizohet.

5. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve të informojnë të gjitha subjektet importuese të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

6. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

7. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit



në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht që vijnë nga vendet e sipërcituara në pikën 2.

8. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Drejtoria e Politikave Veterinare, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Andis Salla

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2025

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 48 lekë

